



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:080374

Datë: 04.07.2019

Numri i dokumentit: 00392523

P.nr.242/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Sabedin Mushica, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Igballe Azemi, në çështjen penale ndaj të pandehurit B.. Y.. nga Gj..., për shkak të veprës penale, ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 paragrafi 1 të KPRK-së, të cilin e mbron me autorizim avokatja ...nga Gj..., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër, PP.II.nr.373/2019, e datës 18.03.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar e publik, me datën 16.04.2019, i përpiluar me datë 03.06.2019, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B...Y..., nga babai N., nëna Sh... e lindur Q..., i lindur me datë..., në Gj... ku edhe jeton, Rruga "...", i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 12.03.2019, rreth orës 05:13 minuta, në rrugën "...", në Gjilan, saktësisht përball pompës së derivateve "...", i pandehuri derisa ka drejtuar automjetin e tij "...", me tabela të regjistrimit..., nga pakujdesia ka shkel Ligjin për Rregullimin e Trafikut Rrugor nga neni 233 dhe neni 53 par. 1, respektivisht drejtimi i automjetit nën ndikimin e alkoolit me ...alkool në gjak dhe mos përshtatja e shpejtësisë, kushteve dhe fushëpamjes së rrugës, gjendjes dhe llojit të rrugës, ashtu që të jetë në gjendje ta ndalë automjetin në çdo pengesë që mund të paraqitet me kushtet e dhëna brenda kufijve të fushë pamjes, dhe mosrespektimi i kësaj dispozite për pasojë humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit dhe fillimisht godet anësoren e majtë të rrugës në drejtim të lëvizjes dhe rrokulliset automjeti i tij dhe në këtë rast përpos dëmeve materiale në automjetin e tij i njëjti dëmton rëndë shtyllën e ndriqimit elektrik.

Me këtë ka kryer veprën penale, ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 4, 41, 42, 43, 46, 73, 74 dhe 75 të KPRK-së, nenit 233 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që i pandehuri, ....., dënohet me dënim me gjobë, në shumë prej 300€ (treqind euro) të cilin dënim do ta paguajë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri i lartëcekur nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë dënimin e me gjobë, gjykata të njëjtit do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku një ditë burgim do t'i llogaritet me 20€ gjobë.

Pala e dëmtuar Drejtoria për Shërbime Publike Infrastrukturë dhe Banim në Komunën e Gjilanit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i pandehuri që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 (njëzet e pesë) euro, shumë prej 30 euro (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita pasuese kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

## A R S Y E T I M

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 19.03.2019, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën me numër, PP.II.nr.373/2019 e datës 18.03.2019, ndaj të pandehurit ..., për shkak të veprës penale ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 paragrafi 1 të KPRK-së.

Me datë 26.03.2019 prokuroria e shtetit në këtë Gjykatë ka dorëzuar, marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të datës 25.03.2019, të arritur mes Prokurorisë Themelore në Gjilan në njërën anë dhe të pandehurit..., me mbrojtësen e tij avokaten..., në anën tjetër, sipas të cilës marrëveshje kësaj gjykate i është rekomanduar edhe lloji dhe lartësia e sanksionit penal, andaj gjykata ka caktuar seancën dëgjimore lidhur me marrëveshjen e pranimit të fajësisë me datë 16.04.2019, ku kanë prezantuar, prokurorja e shteti, i pandehuri ....me mbrojtësen e tij avokaten....., ku i kanë propozuar gjykatës që marrëveshjen për pranimin e fajësisë ta aprovojë.

### 2.Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Gjykata, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në bazë të nenit 233të KPP-së. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë e arritur mes Prokurorisë Themelore në Gjilan si dhe të pandehurit të lartëcekur, i përmbush të gjitha kushtet ligjore si dhe e njëjta është arritur në bazë të nenit 233 të KPP-së, po ashtu gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar faktin se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 253 paragrafi 1 e 2 të KPP-së.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri e ka kryer veprën penale, ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379

paragrafi 1 të KPRK-së, si në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### 4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1, nën paragrafi 3 të KPRK-së, ka vlerësuar se duhet të aprovet rekomandimi i paraqitur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë që të pandehurit t'i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 300€, të cilin dënim do ta paguajë në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit.

#### 5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit....., duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta obligojë t'i paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 25 euro, si dhe shumën prej 30 euro, për kompensimin e viktimave të krimit edhe atë në kuptim të nenit 39 paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensim e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN  
P.nr.242/2019  
Me datë 03.06.2019

Sekretarja juridike,  
Igballe Azemi

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Sabedin Mushica

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ndaj këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.